



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.599/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Adnan Konushevcu kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Alorita Kadriu me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET i palejuar Anr.599/2021 i paraqitur nga Alorita Kadriu me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Alorita Kadriu më të cilin pretendon se nuk është në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe nuk ka asnjë njoftim nga KQZ për këtë.

Me datë 02.09.2021 PZAP, ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur me apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 02.09.2021 në ora 12:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se apeluësja është në listën e votuesve jashtë Kosovës, me numër të regjistrimit të KQZ-së 2021171000107 dhe se emri i saj gjendet në listën votuese jashtë Kosovës në faqen me numër 248, e cila është publikuar në faqen e KQZ-së.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimet e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Parashtrueses së Apelit i mungon interesi juridik

Me datën 01.09.2021 PZAP-i, ka pranuar një apel nga Alorita Kadriu, në të cilin pretendon se nuk është në listën e votuesve jashtë Kosovës Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021 dhe nuk ka asnjë njoftim nga KQZ për këtë.

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtrueses dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ-ja me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtrueses i apelit se apeluesja është në listën e votuesve jashtë Kosovës, me numër të regjistrimit të KQZ-së 2021171000107 dhe se emri i saj gjendet në listën votuese jashtë Kosovës në faqen me numër 248, e cila është publikuar në faqen e KQZ-së.

PZAP duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjta është në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi Alorita Kadriu gjendet në listën votuese.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.599/2021 më datën 02.09.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Kopushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.